

Mbështetur në rregullorën e punës së Këshillit Akademik, neni 31 dhe statutin e Akademisë, thërras mbledhjen e shtatë të Këshillit të Akademik dhe propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Konstituimi i Këshillit Akademik;
 - a. Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Këshillit Akademik në bazë të raportit të Komisionit Qendror Zgjedhor në Akademi;
 - b. Nënshkrimi i Deklaratave të Etikës;
2. Zgjedhja e kryesuesit të Këshillit Akademik;
3. Zgjedhja e dy anëtarëve për Këshill Drejtues;

Mbledhja do të mbahet në Akademi në sallën e takimeve më 26.01.2022 (e mërkure) në ora 10:00.

Sekretarja e Akademisë

Fatime Krasniqi

E K S T R A K T

Nga mbledhja e XXX e Këshillit Akademik të mbajtur me datë 26.01.2022, në Akademi duke filluar prej orës 10.00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Mevlan Bixhaku – Koordinator i programit - anëtar
2. MSc.Adem Selmani - Koordinator i programit – anëtar
3. Dr.Sc. Eflorim Hajra staf akademik - anëtar
4. MSc. Shpresa Ibrahimimi staf akademik – anëtare
5. Dr.Sc. Astrit Sallauka staf akademik – anëtar
6. Rajmonda Obri - staf administrativ – anëtare
7. Elona Obertinca studente – Përfaqësuese nga Parlamenti Studentor.
8. Fatime Krasniqi - Sekretarja e Përgjithshme e Akademisë - anëtare pa të drejtë vote
9. Dr.Sc. Muhamed Krasniqi Drejtor i akademisë – anëtar pa të drejtë vote
10. Makfire Preniqi - Procesmbajtëse

Mbledhjen e hapi Sekretarja e Akademisë Znj. Fatime Krasniqi e cila sipas rregullores mbi Punën e Këshillit Akademik, e udhëheqë mbledhjen konstituive deri tek zgjedhja e Kryesuesit të Këshillit Akademik. Sekretarja tregoj para anëtarëve lidhur me zgjedhjeve të organizuara në Akademi dhe ecurinë e tyre. Poashtu propozoi për miratuar këtë:

REND DITE

1. Konstituimi i Këshillit Akademik;
 - a. Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Këshillit Akademik në bazë të raportit të Komisionit Qendror Zgjedhor në Akademi;
 - b. Nënshkrimi i Deklaratave të Etikës;
2. Zgjedhja e kryesuesit të Këshillit Akademik;
3. Zgjedhja e dy anëtarëve për Këshill Drejtues;

Rendi i ditës i propozuar unanimisht nga anëtarët e Këshillit Akademik.

I. Konstituimi i Këshillit Akademik i Akademisë Tempulli

Pas miratimit të rendit të ditës nga anëtarët e Këshillit Akademik, Sekretarja, propozoi si procesmbajtëse Makfire Preniqin. Anëtarët e Këshillit Akademik, njëzëri miratuan propozimin e dhënë.

a) Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Senatit në bazë të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm.

Në bazë raportit të atës 17.01.2022 Sekretarja e Akademisë informoi të pranishmit për ecurinë e Zgjedhjeve të Përgjithshme në Akademi që nga shpallja e zgjedhjeve me datën 07.12.2021 nga Këshilli Drejtues i Akademisë ku edhe janë zgjedhur anëtarët e rinjë të Këshillit Akademik nga stafi akademik dhe jo akademik e deri tek zgjedhjet studentore, konstituimin e Parlamentit Studentor. Po ashtu Znj. Krasniqi potencoi rezultatet nga zgjedhjet për anëtarët e Këshillit Akademik dhe bëri verifikimin e mandateve për secilin anëtar dhe e hodhi në votim miratimin e tyre për pranimin e mandatëve për anëtar të Këshillit Akademik. Verifikimi i mandateve u votua njëzëri nga të gjithë anëtarët.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Akademik është 4 vite, fillon nga ky moment dhe vazhdon deri më 30 Shtator 2026.

b) Nënshkrimi i deklaratave etike.

Të gjithë anëtarët e Këshillit Akademik bënë nënshkrimin e deklaratave etike.

II. Zgjedhja e Kryesuesit të Këshillit Akademik.

Sekretarja e Përgjithëshme e Akademisë i njoftoi të anëtarët se sipas Rregullores mbi Punën e Këshillit Akademik, duhet të zgjedhet Kryesuesi i Këshillit Akademik, i cili zgjedhet nga kandidatët e propozuar në Këshill, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Pastaj Drejtori i Akademisë kërkoi nga të pranishmit të propozojnë kandidatët për Kryesues të Këshillit Akademik.

Dr. Sc. Eflorim Hajra për Kryesues të Këshillit Akademik propozon Dr. Sc. Mevlan Bixhakun. Tjera propozime nuk pati dhe ky propozim u hodh në votim.

Anëtarët e Këshillit Akademik, në mënyrë unanime votuan propozimin për Dr. Sc. Mevlan Bixhakun.

Meqenëse kishte propozim vetëm për një kandidat, u propozua që zgjedhja të bëhet me votim të hapur (aklamacion). Anëtarët e KA-së në mënyrë unanime miratuan këtë propozim dhe u vendos që zgjedhja e Kryesuesit të KA-së të bëhet me votim të hapur (me akklamacion).

Propozimi për Kryesues të Këshillit Akademik u hodh në votim dhe anëtarët e Këshillit me vota unanime zgjodhën Dr.SC.Mevlan Bixhakun, Kryesuese të Këshillit Akademik, i cila nga ky moment mori kryesimin e mbledhjes së KA-së dhe ka mandat deri në 30.shtator 2026.

III. Zgjedhja e dy anëtarëve për Këshill Drejtues nga stafi akademik.

Në këtë pikë të rendit të ditës, anëtarët e Këshillit Akademik u njoftuan nga Kryesuesi i Këshillit se në bazë të statitut të Akademisë, Këshilli Akademik duhet të zgjedh dy anëtar nga stafi akademik për të plotësuar pozitat në Këshillin Drejtues të Akademisë. Ai theksoi se siç parashihet me rregulloren në fuqi anëtarët e Këshillit mund të propozojnë kandidat për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Drejtues. Pas kësaj kryesuesi kërkoi nga anëtarët se kush ka ndonjë propozim për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Drejtues. Dr.Sc.Astrit Sallauka propozon Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi kandidate për anëtar të Këshillit Drejtues, Këtë propozim ajo e arsyeton duke u bazuar në punën disa vjeçare dhe kontributin e dhënë të Dr.Sc. Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi si mësimdhënëse si dhe kontributin e saj në zhvillimin e Akademisë është kandidate e denjë për t'u zgjedhur anëtare e Këshillit Drejtues. MSc. Shpresa Ibrahim propozoi Sara Fusha Osmani. Këtë propozim ai e arsyeton duke u bazuar në punën me përkushtim Mësimshënësit në fjalë. Propozime tjera nuk pati. Kryesuesi hodhi në votim këto dy propozime ku konform rregullores në fuqi u votua me votim të hapur (aklamacion) për secilin propozim veç e veç. Pasi që ishin dy propozime dhe duhet të zgjidhen dy anëtar, kryesuesi propozoj që zgjedhja e anëtarëve për KD të bëhet me votim të hapur. Anëtarët e Këshilli Akademik me vota unanime votuan dhe zgjodhën Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi dhe Sara Fusha Osmani anëtarë të Këshillit Drejtues.

Të tjera nuk pati në këtë takim.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Sekretarja e Përgjithshme

Fatime Krasniqi

Kryesues i Këshillit Akademik
Dr.Sc. Mevlan Bixhaku

Procesmbajtësi:
Zj. Makfire Prenqi

